

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41./2014, 53/ 16 dhe 83/18), duke vepruar në bazë të njoftimit për përqendrim të parashtruar nga KVANTOKS TEHNOLOXHI SHPK ÇAÇAK (QUANTOX TECHNOLOGY DOO ČAČAK), me seli në rrugën Episkopa Nikifora Maksimoviqa nr.31, Čačak, Republika e Serbisë, përmes personit të autorizuar Vesna Gavriloska , avokate nga Shoqëria e Avokatëve Čakmakova, avokatë nga Shkupi , në seancën e mbajtur më 14.12.2023, merr këtë

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi me anë të së cilit KVANTOKS TEHNOLOXHI SHPK ČAČAK (QUANTOX TECHNOLOGY DOO ČAČAK), me seli në rrugën Episkopa Nikifora Maksimoviqa nr.31, Čačak, Republika e Serbisë do të fitojë kontroll të plotë të drejtpërdrejtë mbi Shoqërinë e shërbimeve KVANTOKS TEHNOLOXHI SHPKNJ Shkup, me seli në rr. Petar PopArsov nr.8-001 kati 01/1, Shkup - Qendër, Republika e Maqedonisë së Veriut përmes shitblerjes së pjesëve, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit për përqendrim obligohet që për njoftimin për përqendrim të paguaj taksë administrative në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksa administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbarimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, më 10.11.2023, ndërsa e plotësuar më 21.11.2023, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua një njoftim për përqendrim nga KVANTOKS TEHNOLOXHI SHPK ČAČAK (QUANTOX TECHNOLOGY DOO ČAČAK), me seli në rrugën Episkopa Nikifora Maksimoviqa nr.31, Čačak, Republika e Serbisë, me anë të së cilit KVANTOKS TEHNOLOXHI SHPK ČAČAK do të fitojë kontroll të plotë të

drejtpërdrejtë mbi Shoqërinë e shërbimeve KVANTOKS TEHNOLOXHI SHPKNJ Shkup, me seli në rr. Petar PopArsov nr.8-001 kati 01/1, Shkup - Qendër, Republika e Maqedonisë së Veriut përmes shitblerjes së pjesëve.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit nga dita e pranimit të tij dhe në bazën e të dhënave të paraqitura në Njoftimin për përqendrim , shtojcat dhe anekset e tyre, konstatoi si në vijim:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Aktivitetet e biznesit të KVANTOKS TEHNOLOXHI SHPK ÇAÇAK janë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe përfshijnë prodhimin digjital, të gjitha aspektet e zhvillimit të softuerit, QA & testimin, shërbimet e aplikacioneve dhe dizajnin, të ndjekura nga shërbimet dhe mbështetja e menaxhuar e IT.

Aktivitetet afariste të KVANTOKS TEHNOLOXHI SHPKNJ Shkup janë nga sfera e teknologjisë informatike dhe përfshijnë programimin kompjuterik dhe zhvillimin e softuerit, dhe e njëjta ka shitje dhe realizon të ardhura vetëm jashtë vendit.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR

I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Prof. Dr. Владимир Наумовски